



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Pranuesi Received/Delivered	24.11	2	viti god. year
Organ /Njesia Organi /Jedinita Org /Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7391/2022		117



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.887/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.887/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 23.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.887/2022 e datës 10.10.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet procedura e rekrutimit me numër reference RN00009376 për grup të pozitive "Specialist të Ekonomisë - Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1", në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, e shpallur me datën 05.07.2022 nga Komuna e Kamenicës.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Kamenicës, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 10.10.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6016 /2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.887/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Sh.02 Nr.30449 të datës 21.09.2022 të Komisionit të Vlerësimit të Komunës së Kamenicës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit Nr.06/L-144 të Zyrtarëve Publikë, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljen e dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa me datën 26.10.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Kamenicës se bashku me shkresat ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuses me numër të protokollit 6016/2022 të datës 10.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.10.2022 nga Komuna e Kamenicës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimin me numër Sh.02 Nr.22405 të datës 19.07.2022; Akt emërimin me numër Sh.02 Nr.37639 të datës 04.12.2019; Akt emërimin me numër Sh.02 Nr.37624 të datës 04.12.2019; Akt emërimin me numër Sh.02 Nr.27211 të datës 09.09.2021; Vendimin me numër Sh.02 Nr.14672 të datës 11.05.2022; Akt emërimin me numër Sh.02 Nr.25157 të datës 05.06.2017; Aplikacionin e kandidatit A.K të datës 01.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatës B.B të datës 02.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, Certifikatën e lëshuar nga gjykata dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatit B.I të datës 27.07.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, Certifikatën e lëshuar nga gjykata dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatit D.M të datës 01.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, Certifikatën e lëshuar nga gjykata, kopjen e letërnjoftimit si dhe pasqyrën e trustit; Aplikacionin e kandidatit L.D të datës 02.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, Certifikatën e lëshuar nga gjykata dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatit L.K të datës 27.07.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatës M.B.B të datës 27.07.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatit V.J të datës 26.07.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, Certifikatën e lëshuar nga gjykata, kopjen e letërnjoftimit si dhe pasqyrën e trustit; Aplikacionin e kandidatës XH.Z të datës 01.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Konkursin me numër të referencës RN00009376 të datës 05.07.2022; Konkursin me numër të referencës RN00009057 të datës 17.05.2022; Njoftimin me numër Nr.111 të datës 12.08.2022 lidhur me verifikimin paraprak nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin me numër Sh.02 Nr.29662 të datës 15.09.2022 nga Komisioni i vlerësimit lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve; Renditjen përfundimtare të kandidateve të gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin me numër Sh.02 Nr.18577 të datës 16.06.2022 lidhur me zëvendësimin e kryesuesit të komisionit; Vendimin me numër Sh.02 Nr.18453 të datës 14.06.2022

lidhur me formimin e komisionit te pranimit; Vendimin me numër Sh.02 Nr.30449 të datës 21.09.2022 lidhur me refuzimin e ankesës se ankuesit nga komisioni i pranimit; Njoftimin me numër Nr.110 te datës 12.08.2022 lidhur me verifikimin paraprak nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Ankesën e ankuesit e parashtruar tek komisioni i pranimit dhe rezultatet e vlerësimit për ankuesin dhe kandidatin e përzgjedhur e gjeneruar tek SIMBNJ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësishëm të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankuesit *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Kamenicës fillimisht me datën 05.07.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 26.07.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Ekonomisë me numër të referencës RN00009376 lidhur me pozitën "Zyrtar për buxhet dhe financa 1" në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi duke u përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit.

Sipas shkresës me numër Sh.02 Nr.29662 lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm e hartuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit me datën 15.09.2022 del se, kandidati i përzgjedhur është vlerësuar me gjithsejtë 74.4 pikë pikë duke u renditur si kandidati i parë në listë, ndërsa ankuesi sipas kësaj liste është renditur i dyti me gjithsejtë 71.8 pikë.

Ankuesi i pakënaqur me renditjen përfundimtare, parashtron ankesë pranë Komisionit të Vlerësimit, i cili me Vendimin me numër Sh.02 Nr.28843 të datës 21.09.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar. Kundër këtij vendimi ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore kundër Vendimit me numër Sh.02 Nr.30449 të datës 21.09.2022 të Komisionit të Vlerësimit të Komunës së Kamenicës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit Nr.06/L-144 te Zyrtarëve Publikë, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljen e dispozitave materiale, i njëjti pretendon po ashtu se komisioni nuk ka vepruar me profesionalizem gjatë përzgjedhjes së kandidatit, se verifikimi paraprak është bërë në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrieren në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, se komisioni është formuar në kundërshtim me nenin 18 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe se i njëjti në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit nuk është vlerësuar me pikët maksimale sipas nenit 22 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore referuar procedurës dhe kushteve të pranimit të nëpunësve civilë, përkatësisht:

Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, nenin 6 ku përcaktohet se: "Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve; dhe nenin 34 ku përcaktohet se: 1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim:

njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme..... Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitat e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi.12. Komisioni i pranimit përbëhet nga të paktën 5 persona, me këtë përbërje: një (1) përfaqësues nga Njësia përgjegjëse; tre (3) nëpunës civilë të nivelit të mesëm apo të ulët, drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi, dhe një (1) ekspert i jashtëm në procesin e përzgjedhjes nga organizata të specializuara apo universitetet.

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 9 ku përcaktohet se: "1.Shpallja e një procedure konkurrimit publikohet nga Njësia Përgjegjëse në uebfaqen unike të procedurave të konkurrimit dhe emërimit, pjesë e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (në tekstin e mëtejme: "SIMBNJ"). 2.Përveçse përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, shpallja e konkurimit publikohet, sipas rastit edhe në: 2.1. ueb faqen e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, për konkurimet për pranimin në shërbimin civil në Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe në uebfaqet e secilit institucion të administratës shtetërore si vegëz e veçantë e ndërlidhur me SIMBNJ apo në; 2.2. ueb faqen e Institucionit Tjetër Shtetëror për konkurimet për pranimin në këto institucione...", nenin 15 ku përcaktohet se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4.Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve..." Neni 18 ka paraparë se : "Për konkurimin në një Institucion Tjetër Shtetëror, institucioni themelon një Komision Pranimi për të gjitha Grupet për të cilat zhvillohet konkurimi. 2.Komisioni i Pranimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin; 2.2. tre (3) anëtarë nga nëpunësit civilë të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues që ushtrojnë detyrën në pozita punë të specializuara lidhur me fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive për të cilat kryhet vlerësimi i kandidatëve; 2.3. një (1) ekspert i jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore, nga organizata të specializuara apo universitetet e fushës... 6. Paragrafët 4 dhe 6 të nenit 17 të kësaj Rregulloreje, zbatohen përshtatshëmrisht dhe në këtë rast.

Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku me nenin 33 theksohet se : Klasat përbërëse të kategorisë Profesionale, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1-Zyrtar i lartë; Profesional 2 - Zyrtar i mesëm; Profesional 3 -Zyrtar, Profesional 4-Zyrtar Administrativ; ndërsa me Shtojcën Nr.1/9 si kërkesa të përgjithshme formale për klasën Profesional 2 janë përcaktuar: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjisllacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e

kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. Kurse sipas Shtojcës Nr. 2 për Gr. Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale kod nr. 12, si fusha të arsimit janë përcaktuar Psikologji/ Punë Sociale dhe të ngjashme.

Duke ju referuar kuadrit ligjor të përshkruar si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat e administruara të çështjes, ka gjetur se konkursi më numër reference RN00009736 për emrin e grupit "Specialist të Përgjithshëm të Ekonomisë", lidhur me pozitën "Zyrtar për buxhet dhe financa", në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa është shpallur vetëm në web faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ, ndërsa nga organi i punësimit nuk ka dëshmi se konkursi në fjalë është shpallur edhe në mjete tjera të përshtatshme të informimit, kështu që Komuna e Kamenicës ndërlidhur me këtë çështje ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, siç është arsyetuar më lartë.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni i Vlerësimit është themeluar në kundërshtim me nenin 18 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të lëndës ka konstatuar se me Vendimin numër Sh.02 Nr.18453 të datës 14.06.2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës është themeluar Komisioni i Pranimit për zhvillimin e procedurave rekrutuese për pozitat e lira të grupit "Specialist të Ekonomisë", rrjedhimisht Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka konstatuar se në kuptim të hierarkisë së pozitive të punës të anëtarëve, Komisioni i Pranimit nuk ishte i themeluar siç përcaktohet me dispozitat e nenit 18 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse në përbërje të Komisionit të Pranimit nuk ishin së paku tre anëtar të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se lista e ngushtë është shpallur në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 4 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji nga analizimi i provave të lëndës ka gjetur se konkursi me numër reference RB00009376, ka qenë i hapur për aplikim nga data 26.07.2022 deri me datën 02.08.2022, ndërsa sipas provave të lëndës rrjedhë se lista e ngushtë është hartuar me datën 12.08.2022, sipas shkresës me numër Nr.111/12.08.2022 me çka nënkupton se verifikimi paraprak i aplikantëve është bërë brenda afatit ligjor siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 15 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sipas së cilit thuhet se: "4.Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve", andaj në këtë kuptim edhe pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale tek vlerësimi jetëshkrimit, pasi që i njëjti është dashur të vlerësohet nga Komisioni vlerësues me njëzet (20) pikë maksimale, Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës të siguruara nga ana e Komunës së Kamenicës, ka konstatuar se sipas listës mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve, e gjeneruar tek SIMBNJ (pa datë dhe nënshkrim të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit), del se ankuesi tek pjesa e jetëshkrimit është vlerësuar me 16.6 pikë gjithsejtë, mirëpo që tek provat e lëndës, konkretisht tek dosja e ankuesit ka munguar formulari për vlerësimin individual të jetëshkrimit (cv), ku vlerësohet kandidati për secilën fushë me pikë të ndara për nivelin e arsimit, për përvojën domethënëse në punë dhe për trajnimet, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 22

paragrafët 4 dhe 5, ku thuhet se: "4. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet", " 5. secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve" dhe nisur nga ky konstatim, për Kolegjin ka qenë e pamundur të vërtetoj faktin se për secilën fushë ankuesi me sa pikë është vlerësuar, andaj në këtë kuptim edhe pretendimi i ankuesit ka qenë i pamundur të shqyrtohet konform mungesës së këtij formulari dhe se komisioni i vlerësimit me rastin e mos përpilimit të këtij formulari ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatit fitues, po ashtu ka gjetur se njësia përgjegjëse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, sepse bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas dëshmimeve të dorëzuara nga ana e komunës së Kamenicës, është konstatuar se kandidati i përzgjedhur _____, me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, lidhur me përvojën profesionale ka bashkangjitur Diplomën me numër Nr.436 të datës 29.09.2020, sipas së cilës dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore me datën 20.07.2020 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit Publik "Haxhi Zeka" në Gjilan në programin e studimit Menaxhment dhe ka marrë titullin Bachelor në menaxhment BA, ndërsa si përvojë të punës ka prezantuar Letër referencën me numër Nr.02/2022 të datës 26.07.2022, e lëshuar nga _____ në Gjilan, sipas së cilës i njëjti ka punuar në këtë biznes nga data 01.12.2014 deri me datën 30.03.2020 në cilësinë e Përgjegjësit financiar dhe të kontabilitetit. Andaj nisur nga ky fakt e pas analizimit të dispozitave të nenit 12 paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: "**Kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion**", e ndërlidhur me përvojën e punës së kandidatit të përzgjedhur, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se i njëjti me rastin e aplikimit për pozitën e lartcekur, nuk ka paraqitur dëshmitë lidhur me vërtetimin nga përvoja e punës të institucionit përkatës, mbi të cilat dëshmohet saktë periudha e përvojës së punës, pozita të cilën e ka mbajtur dhe për çfarë periudhe kohore ka punuar në atë pozitë, kohëzgjatja në pozitën e caktuar dhe arsyet e shpëputjes së marrëdhënies së punës nga ajo pozitë, apo kontratën e punës e bashkangjitur me pasqyrën e trustit e cila dëshmon saktë përvojën e punës së një kandidatit aplikues, mirëpo si dëshmi për përvojën e punës i njëjti ka dorëzuar vetëm letër referencën me numër Nr.02/2022 të datës 26.07.2022, e lëshuar nga _____ në Gjilan lidhur me dëshminë mbi përvojën e punës, gjë që për Kolegjin ka qenë e pamundur të vërtetoj saktë besueshmërinë e kësaj përvoje të punës pa pasur të bashkangjitur dokumente tjera përcjellëse që e mbulojnë përvojën e punës dhe rrjedhimisht Kolegji i Këshillit vlerëson se kandidati i përzgjedhur nuk e ka përmbushur kriterin e përvojës së punës prej dy (2) vitesh siç është kërkuar me konkurs.

Andaj, për shkak të metave të theksuara në këtë konkurs, si dhe duke marrë parasysh shkeljet procedurale dhe të ligjit material, të evidentuara si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se kjo procedurë e rekrutimit është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafit 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.887/2022, datë 23.11.2022.

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.